FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 71	**2002**	**Nëntor**

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.8950 datë 10.10.2002	Për gjendjen civile ……	1975
Ligj nr.8951 datë 10.10.2002	Për numrin e identitetit të shtetasve……	1994
Ligj nr.8952 datë 10.10.2002	Për dokumentin e identitetit të shtetasve shqiptarë ……	1996
	Vendim i shkurtuar për shpalljen të vdekur të shtetasit Ylli Ymeraj……..	1998
	Kërkesë për shpallje të vdekur të shtetasit Fation Mema..	1998

L I G J
Nr. 8950, datë 10.10.2002

PËR GJENDJEN CIVILE

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i këtij ligji është kuptimi dhe përbërësit e gjendjes civile të shtetasve shqiptarë dhe personave pa shtetësi, si dhe organizimi e funksionimi i shërbimit të gjendjes civile në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji:

1. "Regjistër Kombëtar i Gjendjes Civile" është dokumenti shtetëror ku pasqyrohen përbërësit e gjendjes civile për çdo shtetas.
2. "Regjistri themeltar" është libri me fletë të hapur për çdo familje, ku pasqyrohen, për secilin person, të gjithë përbërësit e gjendjes civile.
3. "Përbërës të gjendjes civile" janë të gjitha elementet e përcaktuara në këtë ligj, që shërbejnë për plotësimin e të dhënave, për qartësimin dhe saktësimin e identitetit të çdo shtetasi.
4. "Përbërës të prezumuar" janë përbërësit e gjendjes civile, që vlerësohen të mirëqenë deri në çastin që vërtetohet ndryshe.
5. "Plotësime me akte" është procesi i plotësimit të të dhënave, të cilat mungojnë në akte.
6. "I ngarkuari i posaçëm i pushtetit vendor" është kryetari i bashkisë ose i komunës ose personi i autorizuar me shkrim prej tij.

Neni 3
Kuptimi i gjendjes civile

1. Gjendja civile është tërësia e të dhënave personale, që vërteton lindjen, ekzistencën, individualitetin e shtetasve, si dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. Këto të dhëna shërbejnë për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të shtetasve në marrëdhëniet me shoqërinë e shtetin shqiptar, si dhe për ushtrimin e funksioneve të organeve dhe institucioneve shtetërore.
2. Gjendja civile e shtetasve shqiptarë me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë vërtetohet, në të njëjtën mënyrë, siç parashikohet në këtë ligj, për shtetasit shqiptarë me banim në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 4
Gjendja civile e shtetasve të huaj dhe e personave pa shtetësi

1. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, me banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, gëzojnë të gjitha të drejtat, sipas këtij ligji, me përjashtim të të drejtave, që lidhen ngushtë

me shtetësinë shqiptare dhe të veçorive në mënyrën e dokumentimit.

2. Gjendja civile e shtetasit të huaj, me banim të përhershëm në Shqipëri, përcaktohet në dokumentet e shtetit përkatës, ndërsa ajo e personit pa shtetësi, në dokumentet e shtetit ku ka lindur ose prej nga ka ardhur.

3. Shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, me banim të përkohshëm, vizitorë ose në kalim tranzit në Shqipëri, kanë të drejtë që, nëpërmjet shërbimit të gjendjes civile, të evidentojnë dhe të vërtetojnë faktet juridike të tyre, të ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë, sikurse çdo shtetas shqiptar, përveçse kur ka pengesë ose procedurë të veçantë me ligj ose marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 5
Karakteri personal i të dhënave

1. Të dhënat individuale e familjare të përbërësve të gjendjes civile kanë karakter personal. Aktet, të dhënat dhe konfirmimet shkresore për gjendjen civile i jepen vetëm personit që i përkasin këto të dhëna, anëtarit të familjes së të njëjtës fletë, kujdestarit, përfaqësuesit ligjor ose me prokurë dhe, pas vdekjes, atyre që kanë legjitimitetin e kërkimit të trashëgimisë ligjore ose trashëgimtarëve testamentarë.

2. Të dhënat individuale e familjare të përbërësve të gjendjes civile mund të kërkohen dhe të merren nga institucionet dhe organet, të cilave kjo e drejtë u njihet me ligj të veçantë.

3. Subjektet që kërkojnë dhe marrin të dhëna të gjendjes civile drejtpërdrejt nga shërbimi i gjendjes civile, i përdorin ato vetëm për qëllimin për të cilin janë marrë, duke u rezervuar në publikimin e tyre, përveçse kur autorizohen sipas ligjit.

Neni 6
Vlera juridike e të dhënave

1. Të dhënat e gjendjes civile janë të vlefshme vetëm nëse lëshohen nga nëpunës të shërbimit të gjendjes civile, në mënyrën e në formën që parashikohen në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

2. Për çdo akt dhe dokument që u jepet shtetasve, institucioneve dhe organeve të autorizuara me ligj, nëpunësi i zyrës së gjendjes civile shënon, në mënyrë të plotë, emrin, mbiemrin, nënshkrimin e vet dhe përdor vulën zyrtare të shërbimit të gjendjes civile.

Neni 7
Papajtueshmëria e veprimeve

Në zyrën e gjendjes civile ku është i emëruar, nëpunësi i gjendjes civile nuk mund të kryejë veprime të gjendjes civile, kur këto i përkasin atij vetë, bashkëshortit e fëmijëve të tij, prindërve, gjyshit, gjyshes, vëllezërve, motrave, vjehrrit ose vjehrrës. Në këto raste veprimet kryhen nga një nëpunës tjetër i shërbimit të gjendjes civile ose nga një person i autorizuar nga drejtuesi i institucionit, ku ky nëpunës kryen veprimtarinë.

KREU II
GJENDJA CIVILE

Neni 8
Përbërësit dhe veçoritë e gjendjes civile të shtetasve

1. Përbërësit e gjendjes civile janë emri e mbiemri, numri i identitetit, datëlindja, vendlindja, vendbanimi, seksi, raportet e atësisë e mëmësisë, vdekja, shpallja i/e zhdukur dhe fakte të tjera të parashikuara nga ligji.

2. Shtetësia shqiptare, si përbërëse e gjendjes civile, është elementi i vetëm dallues nga shtetasit e huaj e personat pa shtetësi dhe të drejta të veçanta të tyre.

3. Elementet përbërëse në dokumentet e shërbimit të gjendjes civile kanë përparësi ndaj të

njëjtave elemente të çdo akti tjetër , shtetëror ose privat, dhe janë të detyrueshme të respektohen.

Neni 9
Numri i identitetit

1. Numri i identitetit është numri unik i papërsëritshëm, që i caktohet çdo shtetasi shqiptar, shtetasi të huaj me qëndrim të përhershëm ose shtetasi të huaj me lidhje ekonomike të caktuara, si dhe çdo personi pa shtetësi nga shërbimi i gjendjes civile.

2. Mënyra e formimit të këtij numri përcaktohet me ligj të veçantë.

3. Për shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi përcaktohet numri i identitetit si për shtetasit shqiptarë.

Neni 10
Veçoritë e disa përbërësve të gjendjes civile

Lindja, seksi, emri e mbiemri, raportet e atësisë, mëmësisë dhe shtetësia janë të drejta personale jopasurore. Këta përbërës njihen e, me përjashtim të seksit, mund të hiqen, të shuhen, të ndryshojnë ose t'u kalojnë të tjerëve vetëm në rastet e në mënyrën e përcaktuar shprehimisht në këtë ligj ose në Kodin e Familjes.

Neni 11
Regjistrimi i familjes

1. Përbërësit e gjendjes civile të familjes dhe pjesëtarëve të saj, pasqyrohen në fletën familjare të regjistrit themeltar të zyrës së gjendjes civile të vendbanimit të përhershëm. Kjo fletë është një dhe e vetme.

2. Çdo pjesëtar madhor, siç parashikohet në Kodin e Familjes, ka të drejtë të veçohet si familje më vete ose të bashkohet me një familje tjetër, duke respektuar rregullat e përcaktuara në këtë ligj për regjistrin themeltar.

Neni 12
Transferimi dhe bashkimi familjar

1. Transferimi i të dhënave të gjendjes civile në një zyrë tjetër të gjendjes civile bëhet me kërkesën e kryefamiljarit, kur ai vërteton ndryshimin e vendbanimit për një afat jo më pak se një vit.

2. Pjesëtari i veçantë madhor mund të kërkojë transferimin e të dhënave në një zyrë tjetër të gjendjes civile, vetëm pasi të ketë realizuar veçimin e tij si familje më vete ose bashkimin me një familje tjetër.

3. Bashkimi i një personi ose i një familjeje me një familje tjetër bëhet me pëlqimin e të gjithë pjesëtarëve madhorë, me anën e deklarimit përpara nëpunësit të shërbimit të gjendjes civile, përveç bashkimit me martesë.

4. Pranimi i një personi ose i një familjeje në një familje tjetër lejohet kur plotësohet minimumi i sipërfaqes së banimit të përbashkët prej 4 metrave katrorë për frymë, përveç bashkimit me martesë dhe birësim.

5. Çdo kryefamiljar është i detyruar të bëjë transferimin e gjendjes civile të familjes jo më vonë se 45 ditë nga ardhja në vendbanimin e ri.

6. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi me banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, për çdo veprim, bashkim me familje tjetër ose transferim të gjendjes civile, njoftojnë organin përgjegjës, sipas ligjit nr.8492, datë 27.5.1999 "Për të huajt".

7. Rregullat dhe veprimet që kryhen nga zyrat e gjendjes civile dhe detyrimet e shtetasve për transferimin e të dhënave të gjendjes civile përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 13
Gjendja civile

Gjendja civile e një shtetasi mund të jetë si vijon:
beqar/e;
i/e martuar;
i/e ve;
ç) i/e shkurorëzuar.
“Beqar/e është shtetasi i cili nuk ka kryer akt martese.
“I/e martuar” është shtetasi i lidhur me akt martese.
4. “I/e ve” është shtetasi i lidhur me akt martese, pas vdekjes së bashkëshortes/it.
5. “I/e shkurorëzuar” është shtetasi, martesa e të cilit është zgjidhur me vendim gjyqësor.

Neni 14
Përbërës të rrjedhur nga ngjarje natyrore

Lindja, koha e lindjes, seksi, mëmësia dhe vdekja vërtetohen rregullisht si fakte juridike nga personat zyrtarë ose privatë të pranishën në ngjarje.

Neni 15
Përbërës të prezumuar ose të rrjedhur nga veprimet e vetë personit

Si fakte juridike të prezumuara me ligj ose të rrjedhura nga veprimet e vetë personit i vërtetohen: zotësia për të vepruar, raportet e atësisë, mëmësisë dhe familja.

Neni 16
Përbërës të rrjedhur nga aktet e organeve të tjera

Birësimi, shtetësia, heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, si përbërës kryesorë, burojnë dhe pasqyrohen vetëm në mbështetje e në përputhje me aktin e organit përgjegjës shtetëror, sipas ligjit. Prej tyre përcaktohen edhe përbërësit e tjerë kryesorë, kur ndryshohen sipas ligjit.

Neni 17
Vërtetimi i martesës

Fakti juridik i martesës lind dhe vërtetohet me dokumentin që pasqyron vullnetin e personave në prani të nëpunësit të gjendjes civile, të të ngarkuarit të posaçëm, të dy dëshmitarëve dhe hartohet në përputhje me dispozitat e kreut V të këtij ligji.

Neni 18
Burime të tjera

Përbërësit e tjerë vërtetohen sipas ligjit nga organet dhe institucionet shtetërore, subjektet juridike shtetërore a private, ose drejtpërdrejt nga ligji i veçantë dhe marrin cilësinë e përbërësit, kur pasqyrohen në dokumentet e gjendjes civile.

KREU III
NATYRA DHE DOKUMENTIMI I PËRBËRËSVE TË GJENDJES CIVILE

Neni 19
Llojet dhe veçoritë e përgjithshme të dokumenteve

1. Gjendja civile e shtetasve vërtetohet dhe dokumentohet në dokumentet bazë të gjendjes civile, të hartuara nga shërbimi i gjendjes civile, në bazë të veprimeve të kryera nga punonjësit e këtij shërbimi ose dokumentet bazë të ardhura nga të tretët sipas ligjit.
2. Regjistrat e gjendjes civile janë:
Regjistri themeltar i gjendjes civile;
Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile;

3. Aktet e gjendjes civile, sipas së cilave bëhen plotësimet e regjistrave të gjendjes civile janë:
akti i lindjes;
akti i martesës;
akti i vdekjes;
ç) dokumentet e tjera bazë, sipas nenit 25.

4. Dokumentet që lëshon zyra e gjendjes civile janë:
dokumenti i identitetit;
certifikata familjare;
certifikata e lindjes:
ç) certifikata martesore;
certifikata e vdekjes.

5. Forma, elementet përbërëse, mënyra e mbajtjes, afati i përdorimit të dokumenteve dhe akteve bazë, që mbahen dhe lëshohen nga zyrat e gjendjes civile, si dhe rregullat e lëshimit të këtyre dokumenteve nga këto zyra, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 20
Dokumenti i identitetit

1. Dokumenti bazë i përhershëm për identifikimin e shtetasve është dokumenti i identitetit.
2. Elementet, forma dhe mënyra e pajisjes së shtetasve me dokumentin e identitetit, përcaktohen me ligj të veçantë.
3. Personat që, për efekt moshe, nuk përfitojnë dokument identiteti, pajisen nga zyra e gjendjes civile me certifikatë lindjeje me fotografi.

Neni 21
Regjistri themeltar i gjendjes civile

1. Regjistri themeltar i gjendjes civile është dokumenti përmbledhës i të gjithë përbërësve të gjendjes civile, i sistemuar për çdo familje, sipas adresës.
2. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, kur kanë banim të përhershëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, përfshihen në regjistra themeltarë të veçantë.

Neni 22
Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile

1. Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile është dokumenti unik shtetëror, ku pasqyrohen përbërësit e gjendjes civile për çdo shtetas.
2. Krijimi dhe administrimi i Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, sipas të dhënave që dërgojnë zyrat e gjendjes civile në bashki e komuna, si dhe shërbimit të gjendjes civile në përfaqësitë diplomatike e konsullore.
3. Krijimi dhe mënyra e mbajtjes së Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 23
Aktet për lindjet, martesat e vdekjet

1. Lindjet, martesat dhe vdekjet pasi të pasqyrohen në akte të veçanta që mbahen për çdo rast të renditura kronologjikisht në libra të veçantë, regjistrohen në regjistrat themeltarë të shtetasve.
2. Aktet e lindjes dhe të vdekjes së shtetasit shqiptar mbahen në zyrën e gjendjes civile, ku ndodhet i regjistruar në regjistrin themeltar, ndërsa akti i martesës mbahet në çdo zyrë të gjendjes civile.
3. Lindjet, martesat dhe vdekjet e shtetasve të huaj ose të personave pa shtetësi pasqyrohen në

libra të veçantë, që mbahen nga përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile të vendit ku janë të regjistruar ose ku lidhet martesa.

4. Aktet e lindjes, martesës e vdekjes, të mbajtura jashtë shtetit, për shtetasit shqiptarë, si dhe për shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi me banim të përhershën në Shqipëri, përcillen në rrugë diplomatike në zyrën përgjegjëse të gjendjes civile shqiptare jo më vonë se 3 muaj pas plotësimit të tyre.

Neni 24

Mënyra e plotësimit të regjistrave

1. Regjistrat themeltarë të krijuar rishtas nga nëpunësi i gjendjes civile plotësohen sipas regjistrit të mëparshëm ose vendimit të organit përgjegjës, sipas këtij ligji. Në këtë regjistër, kur ai ruhet, nuk pasqyrohen burimet e të dhënave që kishte regjistri i mëparshëm, por bëhet vetëm referimi i përgjithshëm. Secila fletë familjare plotësohet nga nëpunësi i gjendjes civile dhe vërtetohet nga plotësuesi, duke shënuar kohën e plotësimit, emrin, nënshkrimin e vulën.

2. Regjistrat dhe aktet e gjendjes civile plotësohen me dorëshkrim vetëm nga nëpunësi i gjendjes civile, pasi ka administruar drejtpërdrejt dokumentet bazë ose ka pranuar personalisht deklarimet për faktin e lindjes, lidhjen e martesës ose vdekjen, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

3. Në librat e akteve, përbërësit e gjendjes civile të nëpunësit, të ngarkuarit të posaçëm të pushtetit vendor, të dëshmitarëve ose të deklaruesit të faktit, pasqyrohen sipas dokumentit të identitetit, ndërsa përbërësit e gjendjes civile për personat, të cilëve u përpilohet akti, plotësohen vetëm sipas regjistrit themeltar, drejtpërdrejt ose me certifikatë nga zyra përkatëse.

Neni 25

Dokumentet e tjera bazë

1. Dokumentet e tjera bazë janë aktet zyrtare ose private, të cilat vërtetojnë faktet e tjera juridike, sipas ligjit, ose ndryshojnë faktet juridike të vërtetuara me librat e akteve të gjendjes civile. Përmbajtja e tyre, kur pasqyrohet në regjistrin themeltar, shndërrohet në përbërës të gjendjes civile të shtetasit.

2. Dokumentet e tjera bazë, si dhe i gjithë dokumentacioni tjetër me karakter administrativ, plotësohen e administrohen, në përputhje me kriteret ligjore përkatëse, sipas llojit të dokumentit.

Neni 26

Nënshkrimi i akteve

1. Nëpunësi i gjendjes civile, i interesuari, si dhe të pranishmit, kur parashikohet nga ky ligj, nënshkruajnë me të njëjtin mjet, me të cilin hartohet akti, si dhe shënojnë emrin, atësinë e mbiemrin. Nënshkrimi i nëpunësit të gjendjes civile, në çdo rast, shoqërohet me emrin, mbiemrin dhe vulën e zyrës së gjendjes civile, në të kundërt veprimi quhet i pavlefshëm.

2. Kur personi nuk di ose nuk është në gjendje fizike të nënshkruajë, në akt shënohen shkaqet, të vërtetuara me nënshkrim të veçantë të nëpunësit dhe të pjesëmarrësve të tjerë të pranishëm në veprim, si dhe një të ngarkuari të posaçëm të organit të pushtetit vendor përkatës.

Neni 27

Gabimet gjatë veprimeve

1. Gjatë plotësimit të regjistrave themeltarë, çdo gabim në fakt, shifër, fjalë, fjali ose pozicion, anulohet me vizë në tekst, me shënimin “anulohet” të bërë nga nëpunësi i gjendjes civile. Anulimi vërtetohet me emrin, mbiemrin, nënshkrimin e nëpunësit dhe vulën e zyrës, duke rishikuar tekstin rregullisht, përndryshe anulimi dhe teksti i rishkruar janë të pavlefshëm.

2. Kur nuk ka vend për rishkrim, në faqen përkatëse bëhet shënimi sqarues dhe rishkrimi në kolonën e vërejtjeve, i vërtetuar si më sipër.

3. Në plotësimin e librave të akteve, gabimet lidhur me faktin ose me shkrimin nuk korrigjohen, por e gjithë fleta përkatëse anulohet, duke u kryqëzuar me viza me shënimin e nëpunësit

“anulohet”, të vërtetuar me nënshkrimet përkatëse. Kjo fletë mbetet në regjistër dhe në fletën pasardhëse hartohet akti me të njëjtin numër.

4. Kur në secilin lloj regjistri apo libër aktesh vërehen gabime materiale, “anulimi” shoqërohet me shpjegimet sqaruese.

5. Përmbajtja e fletës familjare të regjistrit themeltar është e pavlefshme kur përbërësi i përket periudhës para krijimit të regjistrit dhe nuk ka dorëshkrimin e plotësuesit të parë të asaj flete ose, pavarësisht nga periudha që i përket, nuk mbështetet në një libër aktesh ose dokument bazë të pasqyruar si burim edhe në faqen përkatëse të asaj flete familjare.

Neni 28

Plotësimet në dokumentet e gjendjes civile

1. Kur në regjistrin themeltar gjendet rubrikë që nuk pasqyron përbërësin përkatës, bëhet plotësimi me miratimin e drejtuesit të zyrës së gjendjes civile kur:

a) përbërësi figuron në librin e akteve të asaj zyre ose të vendit prej nga ka ardhur me transferim për çdo shkak;

b) i interesuari paraqet dokumentin bazë nga burimi përgjegjës, sipas ligjit;

c) vërtetohet në të gjitha rastet e tjera, me vendim gjykate.

2. Kur në librin e akteve gjendet një rubrikë që nuk pasqyron përbërësin përkatës, bëhet plotësim mbi bazën e aktit të origjinës ose me vendim gjykate.

3. Aktet dhe dokumentet bazë të lëshuara jashtë shtetit, që kanë mangësitë e mësipërme, nuk pranohen për veprim nga shërbimi i gjendjes civile.

4. Kur i interesuari vërteton se organi i atjeshëm refuzon ose është e pamundur të bëhet plotësimi për shkaqe objektive dhe kur në atë shtet nuk njihet përbërësi sipas ligjit shqiptar, plotësimi bëhet me vendim gjykate.

Neni 29

Detyrimet e organeve të tjera

1. Të gjitha organet, që në mbështetje të këtij ligji ose ligji të veçantë, janë përgjegjëse për caktimin, vërtetimin ose ndryshimin e një përbërësi të gjendjes civile, detyrohen të dërgojnë, zyrtarisht e drejtëpërdrejt, një kopje të vendimit në zyrën ku personi figuron në regjistrin themeltar, brenda 15 ditëve nga lëshimi i aktit ose nga marrja e formës së prerë të vendimit.

2. Kur në rastet e parashikuara në këtë ligj, veprimi kryhet për persona që figurojnë në regjistrin themeltar të një zyre tjetër, kopja e vendimit i dërgohet zyrtarisht asaj zyre brenda një afati 5-ditor.

Neni 30

Administrimi i dokumentacionit

1. Regjistri themeltar, librat e akteve dhe të dhënat që përmbajnë këto regjistra plotësohen dhe përdoren sipas përcaktimeve të këtij ligji e ligjeve të tjera të veçanta.

2. Regjistri themeltar mbahet për përdorim në zyrën përkatëse me të gjitha vëllimet shtesë. Kur bëhet regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë, krijohet regjistër i ri, ndërsa regjistri i vjetër dorëzohet menjëherë në arkivin e degës së gjendjes civile në qark. Ky regjistër ruhet përgjithmonë.

3. Librat e akteve mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti, dorëzohen në arkivin e degës së gjendjes civile të qarkut jo më vonë se data 10 janar e vitit pasardhës dhe ruhen përgjithmonë.

4. Dokumentet mbi të cilat bazohet formulimi i akteve të gjendjes civile, vendosen në arkivin e zyrës së gjendjes civile në bashki ose komunë muajin e parë të vitit pasardhës dhe ruhen 10 vjet.

5. Për administrimin e gjithë dokumentacionit, shërbimi i gjendjes civile zbaton rregullat e përgjithshme për arkivat, për sa nuk parashikohet dhe nuk bie në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 31

Evidentimi dhe shfrytëzimi i përmbajtjes së regjistrave me sisteme informatike

1. Përmbajtja e regjistrave, librave të akteve dhe veprimet me to, duhet të bëhen dhe me teknika informatike.

2. Krijimi, rregullat për shfrytëzimin e teknikës dhe të rrjetit informatik përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

KREU IV
REGJISTRIMI I AKTEVE TË LINDJES

Neni 32
Dokumentet bazë të lindjes

1. Lindjet si fakt, kohë, vend, seks e mëmësi, vërtetohen me raport mjekësor ose procesverbal të hartuar në kohën e lindjes, i cili vërtetohet nga personeli mjekësor i pranishëm ose i ngarkuari i posaçëm i pushtetit vendor, si dhe përgjegjësi ose kapiteni i trenit, i anijes ose i avionit në udhëtim, komandanti i burgut ose i repartit ushtarak, apo zyrtarë të përfaqësive diplomatike jashtë shtetit. Dokumentet e mësipërme shërbejnë për plotësimin e aktit të lindjes.

2. Kur lindja ndodh pa praninë e mjekut dhe jashtë institucioneve të përmendura në pikën 1, vërtetimi bëhet në bazë të raportit të mjekut pasi ai merr kontakt me nënën dhe fëmijën.

3. Kur organet gjenitale të fëmijës kanë çrregullime, seksi përcaktohet vetëm me raport mjekësor.

4. Kur lindin binjakë siamezë, të gjallë, ata regjistrohen të lindur më vete.

Neni 33
Dokumentet bazë të personave të gjetur

1. Foshnja e gjetur, të cilës nuk i dihen prindërit, prezumohet e lindur në vendin ku është gjetur dhe në kohën që përcaktohet me raport mjekësor.

2. Foshnja e gjetur, të cilës nuk i dihen prindërit, pajiset me procesverbalin e organeve përkatëse të rendit publik dhe raportin mjekësor të lëshuar nga mjeku i zonës ku është gjetur.

3. Me kërkesë të shërbimit të gjendjes civile ose kryesisht me miratimin e kryetarit të bashkisë ose komunës ku është gjetur foshnja, asaj i caktohet emri e mbiemri, si dhe emra prindërish provizorë, që mund të ndryshojnë me kërkesë të vetë fëmijës, kur bëhet madhore ose me vërtetimin ligjërisht të prindërve.

4. Rregullat e mësipërme vlejnë edhe për të gjeturin që ka humbur kujtesën ose është i paaftë mendërisht dhe që nuk identifikohet. Personit të gjetur mund t'i ndryshojë kjo gjendje në rastet kur i kthehet kujtesa, shërohet mendërisht ose identifikohet në mënyrë tjetër.

5. Në të gjitha rastet e parashikuara në këtë nen, i gjeturi pasqyrohet si familje më vete në regjistrin themeltar të vendit ku vendoset për jetesë, me përjashtim të të gjeturit madhor që flet vetëm gjuhë të huaj e që regjistrohet si person pa shtetësi.

6. Kriteret e përcaktuara në këtë nen zbatohen edhe për personin madhor që ka humbur kujtesën ose është i paaftë mendërisht dhe kur nuk i dihen prindërit ose është gjetur me prindër të vdekur, të paidentifikuar, përveç rastit kur ky person flet vetëm gjuhë të huaj, rast në të cilin trajtohet si person pa shtetësi.

Neni 34
Deklarimi i lindjes

1. Lindja e shtetasit deklarohet te nëpunësi i gjendjes civile nga prindërit, pjesëtarët madhorë të familjes, përfaqësuesit ligjorë ose kujdestarë dhe, në pamundësi ose në mungesë të tyre, nga personat që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen. Deklarimi mund të bëhet edhe nga përfaqësues të nënës me prokurë noteriale. Deklarimi i lindjes së foshnjës së gjetur, të cilës nuk i dihen prindërit, bëhet nga i ngarkuari i posaçëm i pushtetit vendor, nga organi i rendit publik në juridiksionin e të cilëve ndodhet vendi i gjetjes.

2. Deklarimi bëhet në zyrën e gjendjes civile të vendbanimit të prindërve, ndërsa foshnjës së gjetur, të cilës nuk i dihen prindërit, në atë të vendit ku është gjetur. Për fëmijët e lindur jashtë territorit

të Republikës së Shqipërisë nga shtetas shqiptarë me banim të përhershëm në Shqipëri, deklarimi bëhet në shërbimin konsullor shqiptar të vendit ku ka lindur ose në atë të përfaqësive diplomatike dhe konsullore përkatëse dhe, kur kjo është e pamundur, deklarimi bëhet edhe në shërbimin e gjendjes civile të atij vendi.

3. Në raste të veçanta, kur nëna gjendet në pamundësi fizike për të bërë deklarimin, mund të autorizojë një person tjetër.

4. Kur ka vend për dyshime, nëpunësi i gjendjes civile duhet të shikojë fizikisht të lindurin para mbajtjes së aktit të lindjes, veprim që pasqyrohet detyrimisht në atë akt.

5. Deklarimi i lindjes duhet të bëhet brenda 15 ditëve dhe, në raste të veçanta, jo më vonë se 30 ditë nga dita e lindjes. Me kalimin e këtyre afateve lindja konfirmohet vetëm me vendim të gjykatës.

Neni 35
Aktlindja

Akti i lindjes vërteton ligjërisht lindjen e shtetasit.

2. Aktet e lindjes mbahen në librin përkatës të zyrës së gjendjes civile të prindërve, kronologjikisht, sipas datës së deklarimit. Në raste të përligjura ato mund të mbahen edhe në gjendjen civile të vendit ku ka ndodhur lindja.

3. Akti i lindjes është procesverbali, që mbahet për çdo të lindur, i nënshkruar nga nëpunësi i gjendjes civile dhe deklaruesi. Ai përmban:

numrin rendor, datën dhe zyrën e gjendjes civile;

numrin e përkohshëm të identitetit të fëmijës;

identitetin, numrin e identitetit dhe cilësinë e deklaruesit;

ç) numrin e identitetit dhe identitetin e nënës;

datën e plotë dhe orën e lindjes;

dh) vendin e lindjes;

seksin;

ë) faktin nëse ka lindur normal, binjak apo siamez;

atësinë dhe numrin e identitetit kur njihet sipas këtij ligji;

g) shtetësinë kur mund të përcaktohet sipas ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”;

gj) emrin e mbiemrin të caktuar sipas këtij ligji.

Neni 36
Emri e mbiemri

1. Nëpunësi i gjendjes civile, në aktin e lindjes pasqyron emrin që dëshirojnë prindërit e fëmijës, përveç emrave të papërshtatshëm me karakter fyes, imoral ose racist.

2. Refuzimi i regjistrimit të emrit të caktuar mund të kundërshtohet në organet gjyqësore.

3. Kur prindërit nuk bien dakord, nëpunësi i gjendjes civile cakton një emër me shënimin në kllapa “i përkohshëm” deri në zgjidhjen e konfliktit nga gjykata.

4. Nuk ka papërshtatshmëri sipas këtij ligji, kur shkaku ka lindur pas regjistrimit të emrit.

5. Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile, kur konstaton një emër të papërshtatshëm, ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e tij me vendim gjyqësor.

6. Mbiemri është ai i prindërve. Kur secili nga prindërit ka mbiemër të veçantë, vendoset mbiemri i babait dhe, kur e kërkon nëna, të dy mbiemrat. Kur nuk ka atësi të njohur, fëmijës i vendoset mbiemri i nënës. Fëmija jashtë martese merr mbiemrin e vajzërisë së nënës.

7. Kur prindërit kanë vdekur, nuk janë në gjendje fizike ose mendore, apo nuk gjenden, emri caktohet nga pjesëtarët e familjes, të afërmit e tjerë e, në mungesë të tyre, si për foshnjën e gjetur që nuk i dihen prindërit.

8. Kriteret e këtij neni për papërshtatshmërinë e emrit zbatohen edhe për mbiemrin e ri të ndryshëm nga i prindërve.

Neni 37
Ndryshimi i emrit dhe i mbiemrit

1. Emri e mbiemri mund të ndryshojnë në rastet e përcaktuara në këtë ligj ose për shkaqe të arsyeshme. Nuk mund të ndryshojnë emri e mbiemri i një personi ndaj të cilit ka kallëzim ose ka nisur procedimi penal, deri në përfundimin e tij.

2. Emri e mbiemri i madhorit mund të ndryshojnë vetëm me kërkesën e tij ose të subjekteve të përcaktuara në këtë ligj, për rastet e papërshtatshmërisë.

3. Emri i personit mund të ndryshojë pas vdekjes, me kërkesë të personave që kanë atë emër përbërës të gjendjes së tyre civile, dhe që përfshihen në të njëjtën fletë familjare të regjistrit themeltar të zyrës së gjendjes civile të vendbanimit, vetëm për shkak të papërshtatshmërisë.

4. Shërbimi përcakton emrat e papërshtatshëm në kuptimin e këtij ligji, duke marrë mendim paraprak nga institucione të specializuara. Emrat e vlerësuar të papërshtatshëm me vendim gjyqësor përfshihen drejtpërdrejt në përmbledhësen, që i vihet në dispozicion çdo zyre të gjendjes civile.

5. Ndryshimi i emrit e i mbiemrit të prindit pasqyrohet te fëmija i mitur. Te fëmija madhor ndryshimi mund të bëhet me pëlqimin e tij, përveç rasteve të papërshtatshmërisë.

6. Ndryshimi i emrit dhe i mbiemrit bëhet pas miratimit të kërkesës së shtetasit nga drejtuesi i zyrës së gjendjes civile, ku ka regjistrin themeltar. Në rubrikën e vërejtjeve të regjistrit themeltar mbahet procesverbali, ku pasqyrohet shkaku i ndryshimit, emri e mbiemri i ndryshuar dhe nënshkruhet nga nëpunësi i gjendjes civile, kërkuesi dhe të gjithë pjesëtarët madhorë të familjes, të cilët e kanë përbërës të tyre emrin ose mbiemrin e që pranojnë ndryshimin, si dhe drejtuesi i zyrës së gjendjes civile.

7. Mbi bazën e procesverbalit ose vendimit gjyqësor, bëhen korrigjimet në fletën familjare për personat që kanë nënshkruar dhe për të miturit, ndërsa për pjesëtarët e tjerë madhorë vetëm pasi të kenë dhënë pëlqimin me shkrim, të nënshkruar, të procesverbalit, përveç rasteve të vendosura nga gjykata.

8. Personat që e kanë përbërës emrin ose mbiemrin, por që janë familje më vete, bëjnë ndryshimin, me kërkesën e tyre ose kryesisht nga zyra e gjendjes civile, me procesverbal të veçantë në regjistrin përkatës, ndërsa në rastet e papërshtatshmërisë, janë të detyruar të pasqyrojnë ndryshimin brenda 1 muaji nga marrja dijeni.

9. Përveç korrigjimeve të mësipërme, emrit dhe mbiemrit mund t'i bëhen përmirësime dhe korrigjime, që lidhen me ndryshime e saktësime të shkronjave të veçanta, si rezultat i gabimeve materiale të bëra gjatë hartimit apo transferimit të të dhënave. Këto ndryshime bëhen mbi bazën e kërkesës së personit të interesuar, bazuar në një nga dokumentet që vërtetojnë identitetin e të njëjtit person.

10. Ndryshimet, korrigjimet dhe përmirësimet e bëra kryhen në zyrën ku ndodhet regjistri themeltar i gjendjes civile dhe i transmetohen zyrave të gjendjes civile ku janë regjistruar akti i lindjes dhe akti i martesës.

Neni 38
Mungesa e të dhënës

1. Kur e dhëna që kërkohet në aktin e lindjes nuk vërtetohet rregullisht nga deklaruesi, verifikohet pjesa përkatëse, përveç rasteve të shënimeve të përkohshme, sipas këtij ligji.

2. Me vërtetimin e të dhënës apo caktimin përfundimtar, bëhet shënimi plotësues vetëm në regjistrin themeltar, duke saktësuar burimin.

Neni 39
Vlera dhe kundërshtimi i aktit të lindjes

1. Akti i lindjes është i pavlefshëm tërësisht, kur nuk është mbajtur nga shërbimi i gjendjes civile, nuk është përfshirë në librin përkatës dhe nuk është nënshkruar rregullisht. Në raste të tjera akti i lindjes është pjesërisht i pavlefshëm, i pasaktë ose fiktiv.

2. Nuk mund të konfirmohet përmbajtja tjetër nga ajo e aktit të lindjes pa u vërtetuar pavlefshmëria e plotë ose e pjesshme, pasaktësia ose falsiteti i pretenduar për aktin përkatës.

3. Shtetasi, përfaqësuesi ligjor ose kujdestari, si dhe çdo person tjetër që pretendon se i është cenuar një e drejtë ose është privuar nga pasoja juridike të caktuara, pretendimet për pavlefshmëri, pasaktësi e falsitet mund t'i parashtrojnë vetëm gjyqësisht, duke thirrur si të paditur zyrën e gjendjes civile, ku është mbajtur akti dhe deklaruesin, kur nuk është vetë paditës.

4. Njohja ose kundërshtimi i atësisë e i mëmësisë bëhen sipas kritereve të përcaktuara në Kodin e Familjes.

Neni 40
Ndryshimi i të dhënës së aktit të lindjes

Përmbajtja e aktit të lindjes, e pasqyruar në regjistrin themeltar, mund të ndryshohet drejtpërdrejt nga punonjësi i gjendjes civile në rastet e përcaktuara shprehimisht në këtë ligj, për emrin, mbiemrin dhe shtetësinë e përkohshme, ndërsa me kërkesë të shtetasit përkatës, brenda 1 viti nga plotësimi i moshës madhore dhe, pas kësaj, me vendim gjykate.

Neni 41
Plotësimi i të dhënave të aktit të lindjes

1. Në regjistrin themeltar pasqyrohen të dhënat sikurse janë e për aq sa përmban libri i akteve të lindjes, shoqëruar me shënimin për të dhënat e përkohshme ose mangësitë.

2. Kur në aktin e lindjes nuk janë shënuar data, ora, vendi i lindjes dhe seksi, bëhet plotësimi i të dhënave në regjistrin themeltar, sipas raportit mjekësor ose provave shkencore.

3. Kur data e vendi i lindjes nuk mund të përcaktohen, shënohen si të tilla koha e vendi i takimit të deklaruesit me lehonën e vdekur ose koha e vendi i gjetjes së fëmijës.

4. Kur në aktin e lindjes është caktuar emri i përkohshëm, është lënë pa shënuar seksi, mbiemri ose shtetësia, mund të bëhet shënimi në çdo kohë, kundrejt deklarimit e nënshkrimit të përbashkët të prindërve, sipas raportit mjekësor ose me vendim gjykate. Kur fëmija bëhet madhor, kjo e drejtë mund të ushtrohet vetëm prej tij, përveç rastit kur i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar.

KREU V
REGJISTRIMI I AKTEVE TË MARTESAVE

Neni 42
Forma e aktit të martesës

1. Akti i martesës është një procesverbal i mbajtur nga nëpunësi i zyrës së gjendjes civile, në të cilin pasqyrohet marrëveshja e bashkëshortëve të ardhshëm e lidhur në prani të nëpunësit të gjendjes civile, sipas kërkesave të Kodit të Familjes. Akti i martesës firmoset nga kryetari i bashkisë ose komunës apo personi i autorizuar prej tij.

2. Kur nuk janë plotësuar kërkesat për shpalljen e martesës, ka vend për dyshime ose vihen re pengesa ligjore për lidhje martese e parregullsi në dokumentet e identitetit të palëve, ndërpriten veprimet dhe njoftohet përgjegjësi i zyrës. Kur është e mundur, bëhen verifikime të menjëhershme dhe veprimet vazhdojnë vetëm kur rrëzohen shkaqet që sollën ndërprerjen me miratimin e drejtuesit të zyrës, duke e nënshkruar edhe ai aktin e martesës.

Neni 43
Mënyra e mbajtjes së aktit dhe dokumentacioni i kërkuar

1. Akti i martesës mbahet drejtpërdrejt në fletët e librit përkatës, në rend kronologjik, për çdo rast, dhe nënshkruhet nga bashkëshortët në prani të jo më pak se dy personave të tjerë. Kur bashkëshortët nuk dinë ose nuk janë në gjendje fizike të nënshkruajnë, shkaku i mosnënshkrimit pasqyrohet në akt.

2. Martesa lidhet, kur për secilin bashkëshort vërtetohet identiteti dhe gjendja familjare me

certifikatat e lindjes, të cilat janë të vlefshme kur kanë shënimin "Për lidhje martese" dhe janë lëshuar nga zyra e gjendjes civile në territorin e Republikës së Shqipërisë jo më shumë se 15 ditë përpara.

3. Martesa e shtetasit të huaj ose personit pa shtetësi, që banon jashtë shtetit ose është banues i përkohshëm në Republikën e Shqipërisë, me shtetas shqiptar lidhet sipas dokumenteve të shtetit, shtetas i të cilit është ose ku ka banimin e përhershëm të lëshuar jo më parë se një muaj nga data që kërkohet të lidhet martesa, përveç rasteve kur ka mënyra dhe afat tjetër, të përcaktuara në marrëveshje shumëpalëshe ose dypalëshe.

4. Për të huajt në azil ose refugjatë, akti i martesës bazohet në dokumentet personale, të vërtetuara brenda 15 ditëve nga organi kompetent shqiptar për të huajt ose drejtpërdrejt nga të dhënat e këtij organi.

Neni 44
Përmbajtja e aktit të martesës

Në aktin e martesës pasqyrohen treguesit si më poshtë:
a) zyra e gjendjes civile në të cilën kryhet akti i martesës dhe nëpunësi përkatës;
b) data dhe ora e mbajtjes së aktit të martesës;
c) identiteti, numri i identifikimit, vendbanimi dhe gjendja familjare e palëve;
ç) identiteti i të pranishmëve;
d) njohja e palëve me të drejtat e detyrat, sipas Kodit të Familjes;
dh) lloji i martesës, sipas përcaktimeve të Kodit të Familjes;
e) pohimi i vullnetit për të lidhur martesën në atë mënyrë;
ë) mbiemri që do të mbajnë palët pas lidhjes së martesës;
f) njohja e atësisë dhe ose amësisë së fëmijëve të bashkëshortëve të lindur para martesës.

Neni 45
Vendi i lidhjes së martesës

1. Akti i martesës, kur të dy bashkëshortët ose njëri është shtetas shqiptar, mbahet në njërën nga zyrat ose në përfaqësitë diplomatike e konsullore ku këta figurojnë në regjistrin themeltar.

2. Akti i martesës ndërmjet dy të huajve me banim të përhershëm në Shqipëri, mbahet në zyrën e gjendjes civile ku ata figurojnë në regjistrin themeltar.

3. Personat shtetas të huaj ose personat pa shtetësi, me qëndrim të përkohshëm në Shqipëri ose tranzit, mund të lidhin martesë ndërmjet tyre në një zyrë të gjendjes civile me dëshirën e tyre apo kur vërtetohet me raport mjekësor rreziku i vdekjes ose kur njëri ose të dy janë të burgosur në Republikën e Shqipërisë, si dhe kur në vendin e tyre nuk mund të lidhin martesë ose nuk mund të shkohet për shkaqe objektive.

Neni 46
Institucioni ku lidhet martesa

1. Martesa lidhet, rregullisht, në zyrat civile ose në mjedise jashtë tyre të caktuara për lidhjen e martesave, në çdo rast, në prani të lirë të publikut.

2. Përjashtimisht, martesa mund të lidhet edhe në vendin ose institucionin ku ndodhet njëra ose të dyja palët, të sëmurë ose të burgosur, kur mjeku ose drejtuesi i burgut nuk autorizojnë daljen nga institucioni përkatës.

3. Me miratimin e drejtuesit të degës së gjendjes civile në qark, në raste të veçanta, kur arsyetohet nga ana e tij, martesa mund të lidhet edhe në vende të tjera.

Neni 47
Vlera juridike e aktit të martesës

1. Martesa nuk vlerësohet e lidhur kur nuk është mbajtur akti i martesës, kur të dy bashkëshortët janë shtetas shqiptarë ose njëri dhe kur në regjistrin themeltar shtetasi figuron i martuar. Në këtë rast, detyrimisht, bëhet ndreqja e gabimit material, sipas këtij ligji.

2. Martesa është e pavlefshme si për rastet e kritereve të pavlefshmërisë së martesës, sipas Kodit të Familjes, ashtu edhe për rastet kur akti nuk është mbajtur nga nëpunësi i gjendjes civile, nuk pasqyron identitetin e palëve dhe vullnetin e martesës, si dhe nuk është nënshkruar rregullisht.

3. Kur teksti i aktit të martesës është i tillë që nuk krijon siguri për identitetin e vullnetin e palëve dhe nëse akti është mbajtur nga nëpunësi i gjendjes civile, gjykata mund të mos shpallë pavlefshmërinë kur vërteton se ka vetëm parregullsi formale.

Neni 48
Veprimet me aktin e martesës

1. Akti i martesës pasqyrohet në regjistrin themeltar të secilit bashkëshort kur e kanë regjistrimin në të njëjtën zyrë.Kur njëri ose të dy kanë regjistrimin familjar në një zyrë tjetër, bëhet njoftimi i zyrës përkatëse me të dhënat që përmban akti i martesës.

2. Zyra e gjendjes civile të bashkëshortes, pasi plotëson njoftimin, bën transferimin e kopjes së aktit të martesës për në familjen e bashkëshortit, përveç rastit kur në aktin e martesës është vendosur ndryshe.

3. Kur zyra e gjendjes civile në pasqyrimin e një martese të lidhur jashtë kësaj zyre vëren se gjatë hartimit të aktit të martesës nuk janë marrë në konsideratë pengesat ligjore, nuk është zbatuar ose është vepruar në kundërshtim me ligjin, dokumentet i kthehen zyrës dërguese, pa veprim, me sqarimet përkatëse.

4. Secila zyrë, kur krijon bindje për pavlefshmëri të aktit të martesës ose ka vend për ndreqje të gabimeve materiale e të shkeljeve të ligjit, mund t'i kërkojë prokurorit të vendit, ku është lidhur martesa, të paraqesë padi në gjykatë.

5. Akti i martesës, i përkthyer e i noterizuar me shpenzimet e paguara para lidhjes së martesës nga bashkëshortët e ardhshëm, i dërgohet, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, organit kompetent të shtetit, ku ka pasur regjistrimin njëri ose të dy bashkëshortët.

KREU VI
REGJISTRI I AKTEVE TË VDEKJEVE

Neni 49
Akti i vdekjes

1. Akti i vdekjes vërteton ligjërisht vdekjen e shtetasit. Ai është një procesverbal që mbahet nga nëpunësi i gjendjes civile në regjistrin përkatës, në prani të deklaruesit e i nënshkruar prej tyre.

2. Në aktin e vdekjes shënohen:

a) numri i identitetit, identitetet e nëpunësit dhe të deklaruesit;

b) identiteti dhe numri i identitetit i të vdekurit ose konfirmimi i të ngarkuarit të posaçëm të bashkisë ose të komunës, për kufomat e gjetura e pa identitet.

c) numri i identitetit, identitetet e mjekut ose të ekspertit që ka lëshuar raportin;

ç) vendi, koha e shkaku i vdekjes sipas raportit mjekësor;

d) numri e data e shkresës së prokurorisë që ka autorizuar veprimin për rastet e përcaktuara në këtë ligj.

3. Për rastet kur varrimi nuk bëhet në njësinë e qeverisjes vendore, ku i vdekuri ka regjistrin themeltar dhe leja e varrimit jepet nga një zyrë tjetër e gjendjes civile, zyra që lëshon lejen e varrimit njofton për lejen e lëshuar zyrën e gjendjes civile, që mban regjistrin themeltar të shtetasit të vdekur.

Neni 50
Deklarimi i vdekjes

1. Deklarimi i vdekjes bëhet nga çdo pjesëtar i familjes ose i afërt e, në mungesë të tyre ose për personat pa njeri, nga i ngarkuari i posaçëm i bashkisë ose komunës ku ka banuar ose është gjetur i vdekuri.

2. Deklarimet janë të vlefshne, kur shoqërohen me raport mjekësor.

3. Deklarimi i vdekjes duhet bërë brenda 3 ditëve nga ndodhja ose gjetja e kufomës dhe brenda 1 muaji, kur vdekja ka ndodhur jashtë shtetit.

4. Me kalimin e këtyre afateve, nuk mund të mbahet akti i vdekjes përveçse si akt i plotësuar me vendim të gjykatës, sipas kërkesës së deklaruesit ose të prokurorit.

5. Deklarimi i vdekjes mund të bëhet edhe pas varrimit, kur nuk mund të bëhet 12 orë pas vdekjes, për shkak të pushimit javor ose për shkaqe të tjera objektive, raste në të cilat bëhet brenda ditës së parë të punës së zyrës përkatëse.

6. Pas varrimit, deklaruesi i vdekjes është i detyruar, brenda një jave e, kur varrimi bëhet jashtë shtetit, jo më vonë se 1 muaj, të dokumentojë në zyrën e gjendjes civile faktin, kohën e vendin e saktë të varrimit, të dhënat që pasqyrohen në aktin e vdekjes.

Neni 51
Vërtetimi faktik i vdekjes

1. Shtetasi vlerësohet se ka vdekur në fakt, kur vërtetohet me raport mjekësor, në të cilin saktësohen identiteti, fakti, koha, vendi e shkaku i vdekjes së tij. Gjithashtu shtetasi shpallet i vdekur edhe për rastet kur personi dhe organi i interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, bëjnë vërtetimin faktik në rrugë gjyqësore, sipas dispozitave 15-23 të Kodit Civil.

2. Për vdekjet e papritura dhe vdekjet në spitale ose në burgje, raporti mjekësor lëshohet vetëm nga shërbimi anatomopatolog me autopsi, përveçse kur bashkëshorti, prindërit ose fëmijët e të vdekurit kundërshtojnë me shkrim.

3. Kur kufoma nuk mund të identifikohet, vihen re shenja ose dyshohet të jetë vdekje e dhunshme, raporti lëshohet nga eksperti mjeko-ligjor. Në këto raste, pavarësisht nga fillimi ose jo i ndjekjes penale, veprimet në gjendjen civile kryhen vetëm me lejen e prokurorit.

4. Në raportin mjekësor shkaqet e vdekjes klasifikohen në shkaqe shëndetësore, aksidentale ose kriminale.

5. Vendimi i gjykatës që shpall shtetasin të vdekur, pasqyrohet vetëm në kolonën e vërejtjeve të regjistrit themeltar, pa u mbajtur akt vdekjeje.

6. Vdekjet jashtë shtetit vërtetohen sipas ligjit të vendit ku ka ndodhur vdekja, me përjashtim të rasteve kur vdekja ndodh në territorin e përfaqësive diplomatike ose në avionët apo anijet shqiptare në udhëtim në zonat ndërkombëtare, për të cilat zbatohet ky ligj.

7. Shërbimi i gjendjes civile, kur ka të dhëna se persona të vdekur vazhdojnë të qëndrojnë të regjistruar në regjistrin themeltar, mund të ngrejë padi në gjykatë për të vërtetuar vdekjen.

Neni 52
Vërtetimi i vdekjes

Vdekja vërtetohet nga mjekët e caktuar për zona të veçanta, për një periudhë 1-vjeçare nga organi i pushtetit vendor. Kur kufomës i bëhet autopsia, vdekja vërtetohet si nga mjeku i zonës, ashtu edhe nga mjeku që ka bërë autopsinë. Për vdekje të dhunshme ose të dyshimta, si dhe për vdekjet në vendet e vuajtjes së dënimeve me burgim, vërtetimi është i pavlefshën kur nuk vërtetohet nga eksperti mjeko-ligjor me kundërfirmën e prokurorit. Vërtetimi nga mjeku i zonës ose mjekë të tjerë në këtë rast është i pavlefshëm.

Neni 53
Pavlefshmëria e aktit të vdekjes

1. Akti i vdekjes është tërësisht i pavlefshëm kur personi, në fakt, nuk ka vdekur, gjë që vërtetohet me paraqitjen e tij fizike ose ekzistencën pas datës së aktit të vdekjes, në çdo rast me mungesë kufome apo kufomë të një personi tjetër.

2. Akti i vdekjes është i pavlefshëm kur ka vdekur një person tjetër nga ai që përmban akti dhe, në këtë rast, është i detyrueshëm të mbahet akt i veçantë për të vdekurin në fakt.

3. Akti i vdekjes shpallet pjesërisht i pavlefshëm kur nuk i përgjigjet realitetit për sa i përket kohës, shkakut e vendit të vdekjes, kur pasaktësia sjell pasoja juridike.

4. Pavlefshmëria, sipas pikës 1 të këtij neni, konstatohet nga gjykata, pas kërkesës që paraqitet, në çdo kohë nga personi për të cilin është mbajtur akti i vdekjes. Kur personi është i mitur, i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar ose nuk është në gjendje mendore e fizike, këtë të drejtë e kanë përfaqësuesit ligjorë ose kujdestarët e tij e kur nuk ka të tillë ose nuk ushtrohet prej tyre, këtë të drejtë e ka edhe prokurori.

5. Në rastin e pikës 2 të këtij neni, përveç personit që rezulton i gjallë, pavlefshmëria kërkohet edhe nga personat, të cilët kanë pasoja juridike nga mungesa e aktit të të vdekurit në fakt. Kur këta janë të mitur, u është hequr zotësia për të vepruar ose nuk janë në gjendje mendore e fizike dhe nuk paraqitet kërkesë nga përfaqësuesi ligjor ose kujdestari, ose kur nuk ka të tillë, si dhe kur pasojat rëndojnë mbi shtetin, kërkesa paraqitet nga prokurori.

6. Prokurori paraqet kërkesë edhe kur personi që rezulton i gjallë, ndonëse i ka mundësitë, nuk bën kërkesë ose shmanget qëllimisht.

7. Në rastin e pikës 2 të këtij neni, kur nuk mund të përcaktohet identiteti i personit të vdekur realisht, çështja shqyrtohet më vete, duke bërë identifikimin ose jo, por në çdo rast duke urdhëruar mbajtjen e një akti tjetër vdekjeje.

8. Pavlefshmëria, sipas pikës 3 të këtij neni, kërkohet nga të interesuarit, që kanë zotësi juridike ose nga prokurori, kur pasojat rëndojnë mbi të miturit, personave madhorë që u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, kur nuk ushtrohet nga përfaqësuesit ligjorë ose kujdestari, ose kur nuk ka të tillë, si dhe kur pasojat lidhen me shtetin.

9. Me shpalljen e pavlefshmërisë së aktit të vdekjes, shënimet në fletën familjare të regjistrit themeltar anulohen ose ndryshohen, duke pasqyruar veprimin në rubrikën e vërejtjeve dhe në vetë aktin e vdekjes.

Neni 54
Leja e varrimit

Kur deklarimi dhe akti i vdekjes mund të mbahen në ditë pune brenda 12 orëve nga vdekja, leja e varrimit lëshohet nga i njëjti nëpunës i zyrës së gjendjes civile. Në të kundërt, dokumenti që vërteton vdekjen, sipas nenit 51 të këtij ligji, ka të njëjtën vlerë.

Neni 55
Përballimi i shpenzimeve të varrimit

1. Për rastet e vdekjeve, në Buxhetin e Shtetit parashikohen fonde për masën e kontributit të shtetit në përballimin nga familja të shpenzimeve të varrimit.

2. Këshilli i Ministrave përcakton masën e shpenzimeve, procedurën që do të ndiqet dhe institucionet e ngarkuara, për përballimin e shpenzimeve të varrimit për shtetasit shqiptarë që vdesin brenda dhe jashtë vendit.

KREU VII
SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE

Neni 56
Natyra dhe funksioni

Shërbimi i gjendjes civile është institucion shtetëror dhe unik. Ky shërbim, në kuptim të këtij ligji, ushtrohet si funksion i deleguar edhe nga organet e qeverisjes vendore. Ai plotëson, ndryshon dhe mban regjistrat e gjendjes civile, harton aktet e gjendjes civile, sipas përcaktimeve të këtij ligji, kryen shërbime ndaj shtetasve, si dhe publikon ose jep certifikatat për përmbajtjen e tyre.

Kryen veprime paraprake ose plotësuese në regjistrat, sikurse përcaktohet në këtë ligj, mban, publikon ose u jep të dhëna statistikore organeve dhe institucioneve shtetërore ose personave juridikë

privatë, sipas përcaktimeve të ligjit dhe akteve nënligjore.

Neni 57
Organizimi i shërbimit të gjendjes civile

Shërbimi i gjendjes civile është i organizuar si më poshtë:
Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
dega e gjendjes civile në qark;
zyrat e gjendjes civile në komuna e bashki;
ç) shërbimi i gjendjes civile në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore shqiptare.

Neni 58
Të ardhurat, shpenzimet, struktura dhe organika

1. Të ardhurat që sigurohen nga shërbimi i gjendjes civile derdhen në Buxhetin e Shtetit.
2. Shpenzimet për shërbimet e gjendjes civile përballohen nga Buxheti i Shtetit si zë më vete, nëpërmjet buxhetit të miratuar për Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit.
3. Numri i punonjësve të shërbimit të gjendjes civile, struktura dhe organika për çdo njësi të qeverisjes vendore, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 59
Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

1. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile është organi më i lartë i shërbimit të gjendjes civile.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile është në varësi të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit.
3. Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile rekrutohet me konkurs, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.
4. Nëpunësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

Neni 60
Detyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile kryen këto detyra:
përgatit projektaktet në zbatim të këtij ligji;
b) harton dhe i propozon për miratim Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit metodikat dhe rregulloret për funksionimin e zyrave të shërbimit të gjendjes civile;
c) krijon dhe administron Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile;
ç) boton buletine statistikore periodike;
d) bën drejtimin metodik dhe kontrollon veprimtarinë e zyrave të shërbimit të gjendjes civile në qark, komunë dhe bashki, si dhe në përfaqësitë diplomatike e konsullore;
dh) harton programe dhe merr masa për modernizimin e sistemit të shërbimit të gjendjes civile;
e) bashkëpunon me institucione dhe donatorë të interesuar për problemet e shërbimit të gjendjes civile dhe i paraqet ministrit për miratim projektmarrëveshje, në përputhje me procedurat e përcaktuara për këtë qëllim;
ë) merr masa, harton dhe zbaton programe për kualifikimin e punonjësve të gjendjes civile;
f) propozon modelet e dokumentacionit që mbahen dhe lëshohen nga zyrat e gjendjes civile, si dhe programet kompjuterike që do të përdorë ky shërbim;
g) vendos kriteret profesionale që duhen plotësuar nga punonjësit e gjendjes civile;
gj) kryen detyrat e ngarkuara nga ministri, në zbatim të këtij ligji dhe akteve të tjera që lidhen me shërbimin e gjendjes civile.

Neni 61
Dega e gjendjes civile në qark

1. Dega e gjendjes civile në qark përfshihet në strukturën e administratës së prefektit.

2. Emërimi dhe lirimi nga detyra i punonjësve të gjendjes civile në qark bëhet nga prefekti, sipas kritereve të përcaktaura nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

Neni 62
Detyrat e degës së gjendjes civile në qark

Dega e gjendjes civile në qark ka këto detyra:

a) zbaton metodikat e hartuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;

b) administron arkivin e regjistrave të gjendjes civile në shkallë qarku, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

c) lëshon certifikata të shërbimit të gjendjes civile në lidhje me dokumentet që administron vetë dega, me kërkesë të personit të interesuar ose të zyrës së gjendjes civile në bashki ose komunë;

ç) u jep të dhëna institucioneve shtetërore dhe personave juridikë privatë, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;

d) raporton para prefektit dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile për veprimtarinë e degës dhe të zyrave në bashki e komuna;

dh) pranon dhe shpërndan në zyrat e gjendjes civile të bashkive dhe komunave njoftimet që vijnë nga institucionet e tjera shtetërore;

e) kontrollon veprimtarinë që kryejnë zyrat e gjendjes civile në bashki e komuna dhe i propozon organeve kompetente marrjen e masave të nevojshme.

Neni 63
Zyrat e gjendjes civile në bashki dhe komuna

1. Zyrat e gjendjes civile në bashki dhe komuna përfshihen në strukturën e administratës së bashkisë ose komunës përkatëse.

2. Emërimi dhe lirimi nga detyra i punonjësit të gjendjes civile në bashki dhe komunë bëhen nga kryetari i bashkisë ose i komunës, sipas kritereve të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile, kur konstaton shkelje nga punonjësi i gjendjes civile, i propozon kryetarit të bashkisë ose komunës shkarkimin e tij.

Neni 64
Detyrat e zyrave të gjendjes civile në bashki dhe komuna

Zyrat e gjendjes civile në bashki dhe komuna kryejnë këto detyra:

a) hartojnë dhe mbajnë regjistrin themeltar të shtetasve në territorin ku veprojnë;

b) regjistrojnë aktet e lindjeve, martesave dhe të vdekjeve në librat përkatës;

c) lëshojnë certifikata lindjeje dhe familjare, martese dhe vdekjeje, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;

ç) kryejnë veprime të shërbimit të gjendjes civile, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj dhe në aktet nënligjore përkatëse;

d) plotësojnë detyrimet e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, në lidhje me institucionet e tjera shtetërore dhe subjektet e interesuara;

dh) informojnë këshillin dhe kryetarin e bashkisë ose komunës lidhur me veprimtarinë e zyrës së gjendjes civile, sipas kërkesës ose periodikisht, sipas udhëzimeve përkatëse;

e) plotësojnë të gjitha detyrat që përcaktohen me akte të këshillit dhe të kryetarit të bashkisë ose komunës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 65
Gjendja civile e shtetasve shqiptarë me banim të përhershëm jashtë Republikës së Shqipërisë

Përfaqësitë diplomatike dhe konsullore shqiptare mbajnë libra aktesh të gjendjes civile, administrojnë dokumentacionin dhe kryejnë veprime të gjendjes civile për shtetasit shqiptarë, që janë me banim të përhershëm jashtë Shqipërisë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj dhe dispozitave të tjera ligjore.

Neni 66
Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile

Kompetencat dhe veprimet me regjistrat e gjendjes civile, sipas këtij ligji, i kanë vetëm nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile.

Neni 67
Tarifat e shërbimit të gjendjes civile

Shërbimet që kryhen nga zyrat e gjendjes civile në çdo rast kryhen me pagesë nga kërkuesi ose deklaruesi, sipas tarifave të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 68
Kontrolli i shërbimit të gjendjes civile

1. Kontrolli i brendshëm administrativ realizohet nga drejtuesit përkatës të nivelit të zyrave të këtij shërbimi.
2. Organet shtetërore të kontrollit, sipas fushave, ushtrojnë kompetencat e tyre ligjore në veprimtarinë e shërbimit të gjendjes civile.

Neni 69
Kundërvajtjet administrative

1. Në kuptim të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë shkelja ose moszbatimi i dispozitave të parashikuara në nenet 12 pika 5, 34 pika 5, 37 pika 8 dhe 50 pika 3 të këtij ligji. Gjoba për çdo rast është në masën 5000 lekë dhe vendoset nga nëpunësi i gjendjes civile. Veprimet pezullohen deri në pagimin e gjobës.
2. Kundër masës administrative mund të bëhet ankim brenda 10 ditëve te prefekti i qarkut, i cili duhet të shprehet për këtë masë brenda 15 ditëve. Kundër vendimit të prefektit mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së vendimit.
3. Kur ka vepër penale, do të zbatohen dispozitat e Kodit Penal dhe çështja do të kalojë për ndjekje penale.

KREU VIII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 70
Dispozita kalimtare e të fundit

1. Rregullat e parashikuara për kriteret e përfshirjes në regjistrat themeltarë e lidhur me banimin, për personat që janë në një regjistër themeltar si familje më vete, të ardhur pas 31 dhjetorit 1990, zbatohen jo më vonë se 1 vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Brenda këtij afati, shtetasit detyrohen të vërtetojnë se kanë siguruar vendbanimin sipas këtij ligji.

Neni 71

Degët e gjendjes civile në qark do të shërbejnë si ndërmjetëse midis zyrave të gjendjes civile në bashki e komuna dhe Zyrës së Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile deri në informatizimin e plotë të sistemit të shërbimit të gjendjes civile.

Neni 72

Numri i përkohshëm i identitetit që i shënohet fëmijës së porsalindur në aktin e lindjes nga zyra e gjendjes civile në bashki ose komunë, do të mbahet prej tij deri në momentin kur Zyra e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të lëshojë numrin e identitetit përfundimtar. Mënyra e kompozimit të numrit të përkohshëm të identitetit bëhet nga shërbimi i gjendjes civile.

Neni 73
Shfuqizime dhe nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ligji nr.5840, datë 20.2.1979 "Për regjistrimin e akteve të gjendjes civile" shfuqizohet.
2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 12 pika 7, 19 pika 5, 23 pika 3, 31 pika 2, 55 pika 2, 58 pika 3 dhe 67 të këtij ligji.

Neni 74

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3540, datë 7.11.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

L I G J
Nr. 8951, datë 10.10.2002

PËR NUMRIN E IDENTITETIT TË SHTETASVE

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Qëllimi i ligjit është përcaktimi i kuptimit, mënyrës së formimit dhe sferës së përdorimit të numrit të identitetit, si një nga përbërësit e veçantë të gjendjes civile, i cili përcakton dhe shërben për identifikimin e shtetasve shqiptarë, personave pa shtetësi dhe shtetasve të huaj me qëndrim të përhershëm brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

1. Numri i identitetit është unik dhe vendoset nga shërbimi i gjendjes civile. Ai përbëhet nga dhjetë elemente me informacion të koduar dhe ka strukturën e mëposhtme:
Elementi 1-2viti i lindjes
Elementi 3-4muaji i lindjes dhe seksi
Elementi 5-6data e lindjes

Elementi 7-9numri serial brenda së njëjtës datë
Elementi 10element kontrolli.
2. Numri i identitetit lëshohet nga shërbimi i gjendjes civile.

Neni 3

Numri i identitetit shërben:
1. Për Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.
2. Për dokumentin e identitetit.
3. Si numër i sigurimit shoqëror për të identifikuar, regjistruar dhe për të kërkuar përfitime nga sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe për programet e tjera të mbrojtjes shoqërore.
4. Për Regjistrin Kombëtar të Zgjedhjeve.
5. Për sistemin tatimor.
6. Për dëshminë e aftësisë së drejtimit të automjeteve.
7. Për nevojat e organeve dhe të institucioneve të tjera shtetërore, si organeve të drejtësisë, të rendit, të prokurorisë, të mbrojtjes, të arsimit dhe të Zyrës së Regjistrimit të Pasurisë.

Neni 4

Mënyra e kodimit të numrit të identitetit, masat dhe detyrat e organeve shtetërore për pajisjen e shtetasve me numër identiteti, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5

Paragrafët e parë dhe të dytë të nenit 1, nenet 2, 3, 6, 7, si dhe paragrafi i tretë i nenit 13 të ligjit nr.7845, datë 13.7.1994 “Për numrin e sigurimit shoqëror”, shfuqizohen.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 12 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3541, datë 7.11.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

L I G J
Nr. 8952, datë 10.10.2002

PËR DOKUMENTIN E IDENTITETIT TË SHTETASVE SHQIPTARË

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ky ligj përcakton dokumentin e identitetit të shtetasve shqiptarë, me qëllim pajisjen e të gjithë shtetasve shqiptarë, personave pa shtetësi dhe shtetasve të huaj me qëndrim të përhershëm brenda territorit të Republikës së Shqipërisë me një dokument identifikues unik, kriteret për lëshimin e tij, si dhe përmbajtjen e këtij dokumenti.

Neni 2

1. Dokumenti i identitetit të personave është dokumenti bazë, i përhershëm që shërben për identifikimin e shtetasve shqiptarë. Ky dokument lëshohet nga zyra e gjendjes civile, në regjistrin themeltar të së cilës është regjistruar shtetasi.

2. Çdo shtetas duhet të mbajë me vete dokumentin e identitetit.

Neni 3

1. Për pajisjen me dokument identiteti shtetasi duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

a) të jetë i regjistruar në regjistrin themeltar dhe të jetë banor i njësisë vendore, që ka në juridiksion zyra e gjendjes civile, e cila e lëshon këtë dokument;

b) të ketë mbushur moshën 16 vjeç.

2. Çdo shtetas që plotëson kushtet e mësipërme është i detyruar të pajiset me dokument identiteti, brenda afateve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 4

Dokumenti i identitetit mund të lëshohet me ose pa afat.

Dokumenti i identitetit lëshohet me afat për shtetasit me moshë nga 16 deri në 30 vjeç. Pavarësisht nga kjo, dokumenti i identitetit ka afat të paktën 5 vjet nga data e lëshimit.

Dokumenti i identitetit lëshohet pa afat për shtetasit mbi 30 vjeç.

Neni 5

Shtetasi pajiset me dokument të ri identiteti kur:

plotëson kushtet e nenit 3 pika 1 të këtij ligji;

b) njëri nga përbërësit e gjendjes civile, të pasqyruar në dokumentin e identitetit, ka ndryshuar, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi;

c) vërtetohet nga organet përkatëse se dokumenti i identitetit i ka humbur ose i është vjedhur.

Neni 6

Dokumenti i identitetit është një kartë plastike, në të cilën janë pasqyruar qartë dhe shënuar me metoda informatike:

a) përbërësit e gjendjes civile të shtetasit, emri, mbiemri, atësia, amësia, datëlindja dhe vendlindja;

b) fotografia e shtetasit, mbajtës i këtij dokumenti;

numri i identitetit të shtetasit;

ç) nënshkrimi i mbajtësit ose i kujdestarit ligjor;

d) elemente sigurie brenda normave të Komunitetit Europian, numri i të cilave caktohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 7

1. Shkelja e afateve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 3 të këtij ligji përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në masën 5 000 lekë. Të drejtën për vendosjen e gjobës e ka shërbimi i gjendjes civile.

2. Mënyra e vendosjes së gjobës dhe ankimi në gjykatë bëhen sipas ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, i ndryshuar.

Neni 8

Forma, modeli i dokumentit të identitetit dhe mënyra e shpërndarjes miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Ligji nr.4172, datë 13.9.1966 “Mbi pajisjen e shtetasve me letërnjoftim”, ndryshuar me ligjet përkatëse, si dhe të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3542, datë 7.11.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

V E N D I M
(I SHKURTUAR)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Ylli Ymeraj.

K Ë R K E S Ë

Besnik Mema, i lindur në vitin 1949 dhe banues në Tiranë, kërkon shpalljen të vdekur të djalit të tij Fation Tema.

KËRKUESI
Besnik Tema

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:
- Kodin Penal (të azhurnuar);
- Kodin e Procedurës Penale (të azhurnuar);
- Përmbledhjen e legjislacionit në fushën e transporteve (Kodin Rrugor dhe ligjin për transportet, e azhurnuar);



U dorëzua për shtyp më 12. 11. 2002
Doli nga shtypi më 13. 11. 2002

Tirazhi: 4250 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë